**BASHKIA KOLONJË**
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

***Nr. prot*** ***Data:17 10 .2019***

**Për**: BOE LEAD CONSULTING shpk dhe HE-SK 11 shpk

Bashkimi i operatorëve ekonomik **LEAD CONSULTING shpk dhe HE-SK 11 shpk**,me anë të akt-marëveshjes për bashkim të përkohshëm të shoqërive,lidhur më datë **26.07.2019**,në Tiranë me **Nr.3727 Rep** dhe **Nr.2664/3 Kol**, kanë rënë dokort të bëjnë bashkimin e përkohshëm të shoqërive për procedurën e prokurimit me objekt: **Loti 1: Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", Ersekë,** ku operatori ekonomik **"LEAD CONSULTING" shpk** do të realizojë **70 % të shërbimit** ndërsa, operatori ekonomik **"HE-SK 11" shpk** do të realizojë **30 % të shërbimit**.Me anë të Prokurës së Posaçme të datës **26.07.2019**,në Tiranë me **Nr.3728 Rep** dhe **Nr.2065/2 Kol**, operatori ekonomik **HE-SK 11 Shpk** autorizon shoqërinë **LEAD CONSULTING Sh.p.k** me Përfaqësues Ligjor **Z. Ardit Kane** të jetë përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të shoqërive në realizimin e objektit të Kontratës.

***Adresa**: **LEAD CONSULTING shpk**, Tirane Rruga Sami Frasheri," Ndertesa nr.19 dhe*
**HE-SK 11 shpk** *Gjirokaster Tepelene Lagjja "Mustafa Matohiti," Rruga Mustafa Matohiti," banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe.*

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozim", "**Shërbime**".

Numri i referencës së procedurës/lotit: **Loti 1: REF-30645-07-17-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti 1: Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", Ersekë**

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1.** *Operatori ekonomik* **M.A.K Studio SHPK** **L01422017O**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera **648.034 ( Gjashtëqindedyzetëetetëmijëetridhjetëekatër) lekë pa Tvsh.**
*(me numra dhe fjalë)*

***2.*** **BOE LEAD CONSULTING shpk dhe HE-SK 11 shpk**
*Emri i plotë i shoqërisë* *Emri i plotë i shoqërisë*
**L82322016N** **L19008502B**
*numri i NIPT-it* *numri i NIPT-it*

Vlera **656.182 (Gjashtëqindepesëdhjetëegjashtëmijëenjëqindetetëdhjetëedy) lekë pa tvsh.**

**3.**Operatori ekonomik **A.SH. Engineering SHPK** **L31617003F**

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera e ofertës **668.198,2 ( Gjashtëqindegjashtëdhjetëetetëmijëenjëqindenëntëdhjetëetetë pikëdy ) lekë pa Tvsh .**

**4.**Operatori ekonomik **ZENIT&CO shpk** **K61731002D**

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera e ofertës **686,525 ( Gjashtëqindetetëdhjetëegjashtëmijëepesëqindenjëzetëepesë) lekë pa tvsh.**

*5. Operatori ekonomik* **NOVATECH STUDIO SHPK** **L01717030C**

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera **697.491.67 (**Gjashtëqindenëntëdhjetëeshtatëmijëekatërqindenëntëdhjetëenjëpresjegjashtë dhjetëeshtatë**) lekë pa tvsh.**

Etj.____________________________

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**1.** Operatori Ekonomik **A.SH. Engineering Shpk**

Vlera e ofertës **668.198,2 ( Gjashtëqindegjashtëdhjetëetetëmijëenjëqindenëntëdhjetëetetë pikëdy ) lekë pa Tvsh .**

2.Operatori ekonomik **M.A.K Studio SHPK**

Vlera e ofertës **648.034 ( Gjashtëqindedyzetëetetëmijëetridhjetëekatër) lekë pa Tvsh .**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**1.**Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik **A.SH. Engineering SHPK**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 , **" Për Prokurimin Publik ",** ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "**Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik",** i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operator ekonomik **A.SH. Engineering SHPK .**

**a.**Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4.2**,Kapaciteti Teknik , profesional kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Operatori/et Ekonomik duhet te paraqesin një listë të personelit kryesor (Drejtues Teknik), të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve te saj, si dhe CV-në e tyre, Diplomat, Kontratat individuale të punës të noterizuara dhe licencat në mbikqyrje të tyre. Drejtuesit Teknik të kërkuar më poshtë duhet të jenë në licensën e Mbikqyrje/ Koluadimit të Punimeve të Zbatimit të Shoqërisë dhe të figurojnë në listë pagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar me kohë të plotë pune për muajt Janar 2019 – Qërshor 2019 (Formularet E-Sig 025/a.1).*

Lista e Drejtuesve Teknike, të nevojshem për të zbatuar objektin e prokurimit, të këtë:

1. Drejtues Teknik Inxhinier Ndertimi
2. Drejtues Teknik Arkitekt
3. Drejtues Teknik Inxhinier Elektrik
4. Drejtues Teknik Inxhinier Mekanik
5. Drejtues Teknik Inxhinier Gjeodet
6. Drejtues Teknik Inxhinier Mjedisi

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **A.SH. Engineering SHPK** është konstatuar se nuk ka paraqitur dokumentacion për drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi dhe Arkitekt .
**Ndërsa** ,diploma e Drejtuesit Teknik Inxhinier Gjeodet me inicialet A.S nuk është origjinale OSE fotokopje e noterizuar sipas kërkesave të DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1,nenit 53, të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,"Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ( i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall ***të pavlefshme*** ofertën e operatorit ekonomik **A.SH. Engineering SHPK** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2.**Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik **M.A.K Studio SHPK**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 , **" Për Prokurimin Publik ",** ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "**Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik",** i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operator ekonomik **M.A.K Studio SHPK .**

**a.**Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4.2**,Kapaciteti Teknik , profesional kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :
*Operatori/et Ekonomik duhet te paraqesin një listë të personelit kryesor (Drejtues Teknik), të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve te saj, si dhe CV-në e tyre, Diplomat, Kontratat individuale të punës të noterizuara dhe licencat në mbikqyrje të tyre. Drejtuesit Teknik të kërkuar më poshtë duhet të jenë në licensën e Mbikqyrje/ Koluadimit të Punimeve të Zbatimit të Shoqërisë dhe të figurojnë në listë pagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar me kohë të plotë pune për muajt Janar 2019 – Qërshor 2019 (Formularet E-Sig 025/a.1).*

Lista e Drejtuesve Teknike, të nevojshem për të zbatuar objektin e prokurimit, të këtë:
1. Drejtues Teknik Inxhinier Ndertimi
2. Drejtues Teknik Arkitekt
3. Drejtues Teknik Inxhinier Elektrik
4. Drejtues Teknik Inxhinier Mekanik
5. Drejtues Teknik Inxhinier Gjeodet

6. Drejtues Teknik Inxhinier Mjedisi

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **M.A.K Studio SHPK** është konstatuar se nuk ka paraqitur dokumentacion kualifikues për drejtues teknik Arkitekt sipas kërkesës së mësipërme .

**b.**Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4.5** Kapaciteti Teknik , profesional kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre duhet ti referohen VKM nr.354,datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim", si dhe në mbështetje të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, Nr. 5585Prot "Rekomandim mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354,datë 11.05.2016" "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim".*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik konkretisht oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik **M.A.K Studio SHPK** është nën vlerën minimale të lejuar.

Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se vlera e ofertuar nga operatori ekonomik nuk është në përputhje me VKM nr. Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", dhe rekomandimin e APP-së, pasi është më e ulët se vlera minimale e përllogaritur nga autoriteti kontraktor për realizimimin e kësaj kontrate ,cituar në **pikën 2.4.5** të Kritereve te Vecanta te Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

**1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016** "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" sipërcituar në nenin 1 të tij "Fusha e Veprimit" **parashikon shprehimisht se:**

*Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e palnifikimit, projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës) të financuara me fonde publike, të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.*

**Ndërsa në nenin 7** të saj parashikohet shprehimisht se:

*Tarifat për shërbimet duhet të jenë në një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale të përcaktuara në këtë manual në përputhje me LPP.*

**Pika 3 e nenit 7 parashikon se:**

*Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa taifa minimale të specifikuara nga ky manual.*

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtezakonshme për proceduren e prokurimit me objekt: **Loti i Parë: "Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", Ersekë".** Për sa më sipër theksojmë se është detyre e operatorit ekonomik të garantojë që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si rrjedhoje konkudojme se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "M.A.K Studio" shpk, nuk ka përmbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit në respektim të **pikës 2.4.5 të DST.**

**2. Në Rekomandimin Nr. 5585 date 25.07.2017 te Agjensise se Prokurimit Publik** "Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te Specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 354 date 11.05.2016 "Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", si dhe njoftimit Nr. Prot 13565 date 06.11.2017 te Agjensise se Prokurimit Publik "Terheqje Vemendje", ku kerkohet detyrimisht zbatimi i akteve ligjore, nenligjore dhe VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e

Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" parashikohet shprehimisht se:

*"Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 Për miratimin e manualit të tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyerje dhe kolaudim", parashikohet si më poshtë:- Për shërbimet e parashikuara ne vendimin e sipercituar (Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016), APP rekomandon qe, krahas perllogaritjes se fondit limit (i cili perllogaritet nisur nga perqindja maksimale e lejuar), behet perllogaritja e vleres minimale te lejuar (e cila perllogaritet nisur nga perqindja minimale e lejuar), ne varesi te kategorise dhe grupit tarifor , ku ben pjese objekti i prokurimit.*

**- Ne nenin 7, pika 3,** te vendimit te sipercituar, parashikohet se:

*Ne rrethana te jashtezakonshme dhe nese dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund te jene me te uleta sesa normat minimale, te specifikuara nga ky manual."*

*- Ne kete kontekst rekomandojme qe, ne rastet kur nuk dokurnentohet rrethana e jashtezakonshme, autoritetet kontraktore gjate vleresimit te ofertave, duhet t'i referohen vleres minimale te perllogaritur per secilin rast, ne haze te parashikimeve ne VKM Nr.354, date 11.05.2016 Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim."*

*- Ne paraqitjen e ofertave ne kete lloj procedure prokurimi, operatoret ekonomike duhet te mbajne ne konsiderate edhe vlerat minimale te perllogaritura nga autoritetet kontraktore ne zbatim te VKM Nr. 354, date 11.05.2016 Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim."*

**Qëllimi i VKM nr. 354,** datë 11.05.2016 "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*" është që të mbrojë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale që do të bëhen, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm.

Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se, vlerësimi i kësaj oferte është kryer duke mos aplikuar formulën për ofertën anomalisht të ulët referuar ligjit për prokurimin publik, por i është referuar vlerave minimale, pasi operatori ekonomik ka paraqitur një ofertë të papërgjegjshme dhe nën kufirin e përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*", e cila është e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë, pasi ky legjislacion nuk lë në diskrecionin e një autoriteti kontraktor të pranojë argumentat për elementët e veçantë të ofertës ekonomike të operatorëve, përsa kohë që ajo është jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave.

Referuar sa më sipër Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se duke qenë se kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikqyrjes dhe kolaudimit duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura.

Sa me siper u konstatua se vlera e ofertes ekonomike te ofertuar nga Operatori Ekonomik nuk eshte ne perputhje me VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" pasi eshte me e ulet se vlera minimale e perllogaritur nga Autoriteti Kontraktor, per kete procedure.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1,nenit 53, të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,"Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ( i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3 dhe VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" e shpall ***të pavlefshme*** ofertën e operatorit ekonomik **M.A.K Studio SHPK** pasi nuk

plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE LEAD CONSULTING** shpk me nius **L82322016N** dhe **HE-SK 11** shpk me nius **L19008502B** *dhe me adresë:* ***LEAD CONSULTING shpk**, Tirane Rruga Sami Frasheri," Ndertesa nr.19 dhe* **HE-SK 11 shpk** *Gjirokaster Tepelene Lagjja "Mustafa Matohiti," Rruga Mustafa Matohiti," banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe* ,se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej ***656.182 (Gjashtëqindepesëdhjetëegjashtëmijëenjëqindetetëdhjetëedy) lekë pa tvsh,*** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

| | |
|---|---|
| **Emri** | **Bashkisë Kolonjë** |
| **Adresa** | **Sheshi " Rilindja "** |
| **Tel/Fax** | **+355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173** |
| **E-mail** | **bashkia.kolonje@gmail.com** |

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi , por jo me vone se **5 (pesë) ditë** nga marrja e kërkesës me shkrim për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë :01.08.2019**

Ankesa: **PO**

(nëse ka) ka marrë përgjigje me shkresë nr. **2779/1** prot, datë **23 / 08 / 2019**.

Në datën **27.08.2019** autoriteti kontraktor bashkia kolonjë është njoftuar nga komisioni i prokurimit publik nëpërmjet vendimit nr. 1418/1 Prot datë.26.08.2019 me objekt: "Urdhër për pezullim procedure prokurimi".

Me Vendim të Komisionit të Prokurimit Publik nr. **656/2019** prot, datë,**11.10.2019** protokolluar me tonën nr.**3541** prot, datë.**15.10.2019** është vendosur mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "**A.SH Engineering**" **shpk**, për procedurën e prokurimit "**Kërkesë për propozim**", me Nr. **Loti 1: REF-30645-07-17-2019**, me objekt: "**Loti 1: Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", Ersekë"**, me fond limit **789,110 lekë pa TVSH**, zhvilluar në datën **29.07.2019** nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë" dhe autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojme me hapat e mëtejeshem të kësaj procedure.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Erion ISAI**